

## **Komento mbi: “Qëndrueshmërinë e deficitit të llogarisë korente”**

Dr. Erjon Luçi dhe Dr. Evelina Çeliku

Rreth 6 muaj më parë mora pjesë në një mbledhje pune në Poloni të organizuar nga BIS, (Bank of International Settlements) dhe Banka e Polonisë. Në një nga sesionet më pyetën se cili qe mendimi im për deficitin e madh të llogarisë korente në Shqipëri. Duhet ta pranoj që kjo pyetje më kapi në befasi, pasi në atë kohë nuk isha plotësish i mirëinformuar mbi zhvillimet më të fundit të deficitit të llogarisë korente. Përgjigjja ime ishte se, megjithëse deficiti i llogarisë korente është i madh, për sa kohë që ekziston një cikël i mbyllur nga pagesat e huaja te importet, për të nuk do të kishte ndonjë ndryshim të madh nëse pagesat e huaja do të zvogëlohen, kështu që mundësia për të “rrëzuar murin” (për një krizë valutore) ishte akoma e vogël për Shqipërin. Që pas këtij episodi u përhoqa të kuptoja më mirë skenaret e një krize të mundshme dhe të ndonjë të mete në idenë time.

Megjithëse Shqipëria është karakterizuar nga një deficit i madh i llogarisë korente gjatë periudhës më të madhe të tranzicionit, vetëm së fundi madhësia e tij është bërë një problem shqetësues i shumë institucioneve vendase dhe ndërkombëtare. Ndërkohë që shqetësimi më i madh vjen nga madhësia e tij, nevojitet një analizë e plotë për të vendosur nëse kjo është një situatë e paqëndrueshme, e cila mund të çojë në një krizë valutore apo thjesht reflektim i zhvillimeve strukturale nëpër të cilat vendi ynë po kalon. Nga ky këndvështrim ne përvhendesim përpjekjet e Dr. Mançellarit dhe Dr. Xhepës për të hedhur dritë mbi këtë temë të rëndësishme.

Nga prezantimi i z. Mançellari ne pamë që vlerësimi i deficitit të llogarisë korente është një çështje komplekse që e bën shumë të vështirë nxjerrjen e përgjigjeve të qarta nga kjo analizë. Autorët kanë përdorur tregues të ndryshëm për vlerësimin e qëndrueshmërisë së deficitit të llogarisë korente, të cilët në përgjithësi nxjerrin në pah brishtësinë e ruajtjes së qëndrueshmërisë aktuale. Një burim potencial problemesh përfundon me rezultatet e autorëve është besueshmëria e *benchmark*-ëve të përdorur për të gjykuar mbi qëndrueshmërinë. Sidoqoftë, autorët janë kujdesur të theksojnë disa boshllëqe dhe dobësi të këtyre *benchmark*-ëve, sidomos të atyre që lidhen me ndryshime strukturore, të cilat janë aspekte të rëndësishme të Shqipërisë dhe të ekonomive të tjera në tranzicion.

Ne jemi dakord me konkluzionin kryesor të diskutimit, që deficiti aktual i llogarisë korente në Shqipëri është relativisht i qëndrueshëm, pavarësisht madhësisë së tij shqetësuese. Konsiderata tjetër për këtë situatë si “e brishtë” duhet të trajtohet më me kujdes, sepse, në dukje, bie në kontradiktë me konkluzionin kryesor. Brishtësia e deficitit të llogarisë korente mund të klasifikohet si një rast paqëndrueshmërie. **Siç e thonë edhe Milesi-Ferreti dhe Razin (1996):** Nëse vazhdueshmëria e qëndrimit të politikës aktuale dhe/ose e sjelljes aktuale të sektorit privat sjellin nevojën përfundimtarisht “drastike” të politikës ose çojnë në një “krizë”, atëherë kemi të bëjmë me një rast paqëndrueshmërie.

Pra, ne mendojmë se një konkluzion akoma më i përshtatshëm, i bazuar në evidencat e dhëna, është se ndërkohë që qëndrimi i politikës aktuale në Shqipëri mund të konsiderohet si i qëndrueshëm në periudhën afatshkurtër, në atë afatgjatë mund të sjellë disa probleme, nëse nuk ndërmerr masa të caktuara, si ato që propozohen drejt nga autorët. Sidoqoftë, janë shprehur shqetësimë se tronditje të ndryshme gjithashtu mund të shkaktojnë paqëndrueshmëri edhe në periudhën afatshkurtër, të cilave ne duam t'iu kushtojmë vëmendje të veçantë.

Një nga zhvillimet që mund të shkaktojë probleme është ulja e pagesave të emigrantëve me transferimin e familjeve të tyre jashtë, një këndvështrim i mbështetur edhe nga prezantimi vijues i z. Gëdeshi dhe zj. Uruçi. Në studime të ndryshme shpesh është argumentuar se pagesat nga jashtë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit në Shqipëri, si dhe në financimin e një pjese domethënëse të importeve. Sidoqoftë, nuk është dhe aq e qartë se si rënia e pagesave do të conte në një situatë paqëndrueshmërie për llogarinë korente dhe/ose në kriza valutore.

Duke iu referuar sërisht studimit pasardhës të z. Gëdeshi dhe të zj. Uruçi, një pjesë e mirë e të ardhurave të emigrantëve shkon për konsum, dhe shumë pak për qëllime investimi. Prandaj, një ulje e pagesave nga jashtë do të conte në rënie të konsumit. Nëse bëjmë supozimin realist se një pjesë e madhe e konsumit vjen nga importi, rrjedh që një ulje e pagesave nga jashtë do të shoqerohej me një rënie të ngjashme të importeve, që do ta linte deficitin e llogarisë korente pak a shumë të paprekur. Përsa i përket tregut të këmbimit valutor, duke u bazuar në supozimet e mësipërme, duket se ekziston gjithashtu një cikël i myllur që e bën të vështirë lindjen e krizave valutore. Për shembull, nëse familjet e emigrantëve nuk do të shkëmbenin pagesat e emigrantëve në tregun valutor, ndikimi i mundshëm i kësaj rënieje në ofertën e monedhës së huaj do të kishte si kundërveprim rënien e ngjashme të kërkuesës për monedhë të huaj, për sa kohë që importuesit do të zvogëlonin nevojën për monedhë të huaj për të njëjtën shumë.

Mund të argumentohet që mund të ketë një mospërputhje kohore midis rënieve së ofertës dhe asaj të kërkuesës, sepse importuesit mund të mos jenë të sigurt nëse rënia e kërkuesës për importe është e përkohshme apo e qëndrueshme. Në këtë mënyrë, mund të ndodhë një zhvlerësim i shpejtë i monedhës. Sidoqoftë, ne mendojmë se kjo është një situatë jorealiste. Lëvizja e familjeve të emigrantëve jashtë, ka pak të ngjarë të ndodhë në të njëjtën kohë. Kjo do të thotë se edhe pse ka një mospërputhshmëri mes reagimit të importuesve dhe ndryshimit të kërkuesës, ndikimi duhet të jetë shumë i madh në mënyrë që të gjenerojë një kriżë valutore. Gjithashtu, edhe eksperiencia e deritanishme ka treguar se lëvizjet domethënëse të emigrantëve gjatë verës kanë qenë të administrueshme. Nuk ka arsyë të besojmë se lëvizja *graduale* e familjeve të tyre do të kishte një efekt kaq shkatërrues.

Një zhvillim tjetër që do të kishte një ndikim më të rëndësishëm në deficitin e llogarisë korente dhe një rrezik më të madh për një rënie të menjëhershme të flukseve hyrëse të monedhës së huaj në tregun valutor është rënia e të ardhurave nga aktivitetet informale (ilegale) me përmirësimin e rolit të ligjit. Evidencat për tregun informal, ashtu siç e tregoi edhe z. Olters në fjalimin e tij, janë shumë të pakta, dhe çdo gjykim mbi shkallën në të

cilën ai (tregu informal) përdoret për financimin e importeve apo se sa shumë ai kalon mes tregut valutor mbetet i hapur ndaj spekullimeve. Megjithatë, pavarësisht madhësishë së tij, edhe në këtë rast ndikimi duhet të jetë patjetër i madh për të shaktuar paqëndrueshmëri. Për aktivitetet informale por ligjore, të ardhurat nuk do të ndryshojnë me kalimin nga ekonomia informale në atë formale. Përsa i përket aktivitetave ilegale, përvèç faktit që një pjesë e tyre mund të mos kalojnë përmes tregjeve, eksperiencia e vështirësimit të emigrimit ilegal nëpërmjet detit (që mund të ketë patur një ndikim të rëndësishëm në uljen e të ardhurave nga aktivitete ilegale), ka treguar se nuk është shoqëruar me ndonjë përkeqësim. Nga ana tjetër, një zvogëlim i aktivitetit ilegal do t'u jepte një sinjal të fortë investitorëve të huaj se sundimi i ligjit ka filluar të funksionojë siç duhet në Shqipëri. Prandaj, ajo pjesë e deficitit të llogarisë korente që mund të jetë financuar nga të ardhurat e aktivitetave ilegale do të mund të financohej tashmë nga investimet e huaja direkte, (FDI). Sidoqoftë, edhe në këtë rast duhet t'i kushohet vëmendje mospërputhjes kohore, prandaj një ndërhyrje nga Banka e Shqipërisë në tregun valutor do të justifikohej nëse do të kishte shenja të rënies së valutës, deri në momentin që investimet e huaja direkte të fillojnë të nxiten.

Paqëndrueshmëria politike mund të jetë një burim i rëndësishëm i përkeqësimit të deficitit të llogarisë korente, siç e ka treguar edhe eksperiencia e vitit 1977. Megjithëse në vitet e fundit Shqipëria mund të klasifikohet si një vend relativisht i qëndrueshëm në aspektin politik, siç u përmend edhe më lart, besimi i investitorëve të huaj mund të vonojë. Në këto situata të ekuilibrave jo të mirë mund të nevojitet një *shock* pozitiv i jashtëm. Masa të tilla si ngritura nga Banka Botërore e strukturave të sigurimit për investitorët e huaj ndaj rreziqeve politike dhe ekonomike në Shqipëri në vitin 1997 janë një zgjidhje e dobishme. Është e rëndësishme të konsiderohet mbijetesa e tyre në të ardhmen, si zgjidhje që do të nxiste investimet e huaja direkte dhe do të zgjidhë problemin e mospërputhshmërisë së kohës, të përmendur më sipër.

Megjithatë, nevoja për reforma të mëtejshme strukturore për përmirësimin konkurrencës në ekonominë shqiptare është e domosdoshme për të siguruar një qëndrueshmëri afatgjatë të deficitit të llogarisë korente. Ne nuk do të ndalemi në diskutime mbi mënyrat për nxitjen e eksporteve, meqë kjo çështje do të shqyrtohet më intensivisht nga prezantimi pasardhës i z. Çeku. Sidoqoftë, do të donim të bënim disa komente për vlerësimin e kursit real të këmbimit. Duke lënë për momentin mënjanë, paqartësitë për shkallën e vlerësimit të normës reale të këmbimit, e cila varet nga mënyra e përdorur për llogaritjen e saj (Hollar, 2003), mendojmë se në këtë fazë teknikat ekonometrike mund të jenë të pamjaftueshme për të nxjerrë rezultate konkluduese, nëse vlerësimi real i Lekut ka luajtur apo jo ndonjë rol në konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare. Duke marrë në konsideratë se raporti i eksporteve ndaj PBB ka ndryshuar shumë pak që nga fillimi i tranzicionit, është e vështirë të gjendet një lidhje me kursin e këmbimit, i cili ka qenë shumë më i ndryshueshëm për shumë arsy. Sidoqoftë, gjithmonë ekziston një mundësi që ky vlerësim ka rritur presionin e tij në nivelin e ulët të eksporteve dhe konkurrencës. Ne nuk duam të pohojmë se ky është tamam rasti, por për sa kohë që kjo situatë krahasohet me një situatë kur eksportet janë më të ndryshueshme, do të jetë e vështirë për të arrtiur në një konkluzion të qartë. Pra, për të vendosur nëse ky vlerësim është një devijim apo një reflektim i ndryshimeve strukturore, nevojitet një studim i mëtejshëm.

Për të mbyllur diskutimin me një shënim pozitiv, duhet përmendur se qëndrueshmëria në të ardhmen e deficitit të llogarisë korente mund të rritet, gjithashtu, edhe nga privatizimi i pritur i Bankës së Kursimeve, Telekomit, KESH-it, INSIG-ut, të cilët kryesisht do të privatizohen nëpërmjet investitorëve të huaj strategjikë. Megjithatë, duhet të jemi të vëmendshëm ndaj tronditjeve potenciale destabilizuese që mund të çojnë në një situatë paqëndrueshmërie dhe/ose në ndonjë krizë valutore. Në fakt, Banka e Shqipërisë po planifikon ta çojë më tej këtë diskutim, duke investiguar në më shumë detaje problemet që lidhen me qëndrueshmërinë e deficitit të llogarisë korente.